



2025

# RAPORTI VJETOR I PUNËS



N.P.L. Ku'zina sh.a.

Prishtinë

Mars 2026





## Përmbledhje ekzekutive

Ndërmarrja Publike Lokale Ku'zina sh.a. është themeluar nga Kuvendi Komunal i Komunës së Prishtinës në vitin 2019. Megjithatë aktivitetin e saj të punës dhe financiar e ka filluar në mënyrë të pavarur nga Komuna e Prishtinës nga 1 janar 2022. Deri në këtë kohë të gjitha proceset brenda ndërmarrjes janë realizuar nga Komuna e Prishtinës, duke filluar nga pagat, furnizimit, investimet dhe gjera të tjera të nevojshme për ndërmarrjen. E konceptuar si ndërmarrje që do të duhej të ofronte shërbimin e shujtave të ngrohta vetëm për Institucionet Parashkollore në kryeqytet, nga ajo e kohë e deri me tash, i është nënshtruar një evoluimi të shpejt.

Disa nga të arriturat kryesore të Ku'zines sh.a. janë të strukturuar në disa fusha me të rëndësishme: investimet kapitale, zhvillimet teknologjike, qëndrueshmëria financiare.

### 1. Investimet kapitale në periudhën e tanishme në Ku'zina sh.a.

- Blerja e pajisjeve të reja për operim afarist, përfshirë: pajisje profesionale për përgatitjen e ushqimit, mjete për shpërndarjen për nevoja logjistike;
- Bashkë-investim me Komunën e Prishtinës për instalimin e paneleve solare (vlëra: 30,000 €), duke rritur efikasitetin energjetik dhe qëndrueshmërinë mjedisore;
- Blerja e mini-kuzhinave për shkolla fillore – mbështetje për programin e mësimin tërëditor, Zgjerimi i aseteve fizike dhe teknologjike në kuzhinë, duke përfshirë: instalimin e pajisjeve moderne për gatim, përmirësimin e linjave të shpërndarjes së ushqimit.

### 2. Zhvillimet në përmirësimin e teknologjisë së prodhimit dhe shërbimit të ne Ku'zina sh.a.

- Digjitalizimi – plani ideor i finalizuar dhe parashikohet zbatimi deri në fund të vitit, ku do të përfshihen digjitalizimi i proceseve të punës: Përfshin sistemet e porosive, menaxhimit të rezervave, dhe ndjekjen e shpërndarjes
- Aprovimi i menysë së re - kalimi nga meny javore në meny katër javorë, për më shumë varietet dhe balancim ushqimor, duke u bazuar në rekomandimet profesionale të nutricionistëve dhe teknologëve të prodhimit të ushqimit dhe modeleve me të mira e të ushqyerit të fëmijëve nga vendet me traditë të pasur (si Austria, vendet nordike etj.). në këtë fazë është duke u përgatitja e recetat e menysë së re (standardizimi i recetave) për të gjitha ciklet e arsimit. Trajnime të rregullta për stafin në fushat e Sigurisë ushqimore; Shëndetit në punë dhe standardeve HACCP
- Zbatimi i planit ideor për “Shkolla të sigurt - ushqim i sigurt”, në bashkëpunim me Komunën
- Mbështetja e koncepteve të qëndrueshmërisë, si përdorimi i energjisë diellore dhe zvogëlimi i mbetjeve

### 3. Qëndrueshmëria financiare dhe rritja e të ardhurave

Ku'zina ka shënuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe të matshëm gjatë periudhës 2022–2025, duke rritur ndjeshëm kapacitetin prodhues dhe performancën financiare. Nga viti 2022 deri në fund të vitit 2025, numri i shujtave të prodhuara është rritur nga 602,773 në 1,384,050, që





përfaqëson një rritje prej mbi 129% në vetëm katër vite. Paralelisht, të hyrat janë rritur nga 658,211.46 € në 2,412,366.11 €, duke reflektuar jo vetëm një rritje të volumit të shërbimeve, por edhe përmirësim të efikasitetit ekonomik dhe menaxhimit të burimeve.

Të hyrat për shujtë kanë shënuar përmirësim të vazhdueshëm – nga 1.09 € në vitin 2022 në 1.74 € në vitin 2025, gjë që tregon një rritje të dyfishtë të efikasitetit për njësi. Ky progres tregon për një model të suksesshëm operacional, që ka arritur të balancojë rritjen e kapaciteteve me menaxhimin efektiv të kostove dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit. Bazuar në këto tregues, Ku'zina po konsolidohet si një ndërmarrje publike e suksesshme, e aftë të përshtatet me kërkesat në rritje dhe të sigurojë qëndrueshmëri financiare në afat të gjatë.

Këto suksese kanë ardhur edhe si rezultat i përfshirjes së ofrimit të shërbimeve edhe për sektorin privat, me fillimin e shërbimeve të ushqimit për kompani private – rezultat i menjëhershëm: të hyra shtesë dhe diversifikim i tregut. Gjithashtu ndikim të veçanta ka pasur edhe zgjerimi i bazës së klientëve të institucioneve publike, ku përveç sistemit arsimor, janë shtuar institucione sociale dhe emergjente

Të arritura të veçanta që do kenë ndikim strategjik në zhvillimin dhe rritjen e Ku'zines


- Përgatitja dhe miratimi i Strategjisë Zhvillimore 2025–2029, që orienton zhvillimin afatgjatë.
- Fillimi i zbatimit praktik të mësimin tërë ditë në ciklin e ulët shkollor – ndikon drejtpërdrejt në rritjen e kërkesës për shujtë cilësore.
- Zgjerimi i menysë për sektorin privat, duke ofruar ushqime të diversifikuara si: gjellë ditore, pasta, ushqim i shpejtë, rizoto, dhe ushqime tradicionale.

*Tabela: Të arriturat sa i përket rritjeve për vit: të shujtave dhe të hyrave financiare*

| Nr. i shujtave të prodhuara | Numri i shujtave | Të hyrat në euro |
|-----------------------------|------------------|------------------|
| Viti i parë 2022            | 602,773 shujta   | 658,211.46       |
| Viti i dytë 2023            | 620,391 shujta   | 1,126,042.00     |
| Viti i tretë 2024           | 887,946 shujta   | 1,813,786.38     |
| Viti i katërt 2025          | 1,384,050 shujta | 2,412,366.10     |
| Totali                      | 3,495,160 shujta | 6,010,405.95     |



Rritja vjetore e shujtave dhe e të hyrave financiare (2022-2025)




#### Krahasimi i numrit të shujtave ndër vite

- 2022 → 2023: Rritje e lehtë prej +2.9% në numrin e shujtave.
- 2023 → 2024: Rritje e ndjeshme prej +43%, që tregon një zgjerim të kapaciteteve ose rritje të kërkesës.
- 2024 → 2025: Të gjithë vitin 2025 janë prodhuar 1,384,050 shujta që është rritje prej +55.87% më shumë krahasuar me vitin 2024

Ekziston një trend shumë i fortë rritës në prodhimin e shujtave, sidomos në vitin 2024 dhe 2025. Ky trend sigurisht që përcillet edhe me të hyrat me të mëdha të realizuara që do orientohen në realizimin e synimeve strategjike zhvillimin dhe modernizimin e Ku'zines sh.a.

#### Krahasimi i të hyrave ndër vite

- 2022 → 2023: Rritje prej +71% në të hyrat, pavarësisht rritjes së vogël në numrin e shujtave.
- 2023 → 2024: Rritje prej +61% në të hyrat.
- 2024 → 2025: Të hyrat në 2025 janë 2,412,366 €, që përbën +33% me shumë krahasuar me vitin 2024



### Analiza e të hyrave për shujtë (efikasiteti ekonomik) – analizat vjetore

**2022 – Bazë fillestare (1.09 €/shujtë)-** të hyrat për shujtë janë në nivelin më të ulët nga të gjithë vitet e analizuara. Ky mund të konsiderohet si **viti bazë**, me çmime më konservative, kontrata më të hershme ose efikasitet më të kufizuar në strukturën e kostove.

**2023 – Rritje e fortë (1.81 €/shujtë | +66%)** – kjo rritje e të hyrat për njësi tregon për një **ndryshim të rëndësishëm në modelin financiar**. Arsyet e kësaj rritje të madhe ishin kryesisht: marrëveshje më të favorshme. Përmirësim i standardit të shërbimit që ka justifikuar çmim. Ulje e kostove për njësi me rritjen e volumit (efektet e shkallës).

**2024 – Rritje e qëndrueshme (2.04 €/shujtë | +12.7%).** Në këtë vit ka pasur rritje më modeste, por vazhdimësi e trendit pozitiv. Kjo tregon që **kapacitetet operative janë të qëndrueshme** dhe se është krijuar një balancë më e qëndrueshme mes çmimit dhe kostove.

**2025 – Rritja e efikasitetit po vazhdon. Tani shkalla e efikasitetit është (1.74€/shujtë).** Kemi një **rritje të mtejshme të efikasitetit ekonomik**, kjo tregon qe Ku'zina sh.a. ka arritur: një strukturë të konsoliduar financiare dhe mundësi që rritja e të hyrave nuk po vjen vetëm nga volumi, por edhe nga menaxhim me i mire. **Gjatë kësaj periudhe është realizuar nivel i lartë në efikasitetit ekonomik.** Ky trend gjatë këtij viti pritet të jetë edhe me i lartë duke pasur parasysh edhe pritjet që janë për rritjen e klientëve si nga institucionet publike ashtu edhe nga ato të sektorit privat.

### 3. Hyrje

- Qëllimi i raportit vjetor për periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2025

Qëllimi i Raportit Vjetor të NPL Ku'zina është të paraqesë në mënyrë të strukturuar, transparente dhe të plotë aktivitetet, performancën operative dhe financiare të ndërmarrjes gjatë vitit raportues. Raporti synon të informojë organet mbikëqyrëse, themeluesin, institucionet relevante dhe publikun mbi realizimin e mandatit, objektivave strategjike dhe detyrimeve ligjore.

Në mënyrë specifike, raporti ka për qëllim:

- Të pasqyrojë realizimin e planit vjetor të punës dhe arritjen e objektivave të përcaktuara.
- Të paraqesë performancën financiare dhe menaxhimin e burimeve.
- Të raportojë mbi cilësinë e shërbimeve dhe respektimin e standardeve të sigurisë ushqimore.
- Të identifikojë sfidat, rreziqet dhe masat e ndërmarra për përmirësim.
- Të sigurojë transparencë dhe llogaridhënie ndaj institucioneve dhe qytetarëve.

Raporti vjetor shërben si dokument bazë për vlerësimin e performancës së ndërmarrjes dhe për planifikimin strategjik të aktiviteteve për vitin pasues.

- Baza ligjore dhe institucionale:

NPL Ku'zina funksionon mbi bazën e legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës dhe akteve nënligjore përkatëse që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve publike, si dhe fushën e sigurisë ushqimore dhe menaxhimit financiar. Baza ligjore mbi të cilën mbështetet veprimtaria e saj përfshin Ligjin për Ndërmarrjet Publike, i cili rregullon themelimin, organizimin, qeverisjen korporative dhe mbikëqyrjen e ndërmarrjeve publike; Ligjin për Shoqëritë Tregtare, që përcakton formën juridike të shoqërisë aksionare, strukturën e organeve drejtuese dhe përgjegjësitë e tyre. Në aspektin institucional, NPL Ku'zina funksionon nën mbikëqyrjen e themeluesit (Komunës së Prishtinës), e cili ushtron rolin e aksionarit dhe siguron mbikëqyrje strategjike përmes organeve përkatëse.

Struktura institucionale përfshin:

- Bordin e Drejtoreve, i cili mbikëqyr menaxhimin dhe miraton politikat strategjike.
- Menaxhmentin ekzekutiv, përgjegjës për zbatimin e politikave dhe operimin ditor.
- Njësitë operative dhe administrative që realizojnë shërbimet ushqimore dhe aktivitetet mbështetëse.

Gjithashtu, ndërmarrja bashkëpunon me institucione të tjera relevante, si autoritetet komunale, organet e inspektoratit, autoritetet e sigurisë ushqimore dhe institucionet financiare, duke siguruar respektimin e plotë të standardeve ligjore dhe profesionale.

- Metodologjia e raportimit

Raporti Vjetor i NPL Ku'zina është hartuar mbi bazën e një metodologjie të strukturuar, e cila siguron saktësi, transparencë dhe përputhshmëri me kërkesat ligjore dhe standardet e qeverisjes korporative për ndërmarrjet publike.



Të dhënat e përfshira në raport janë mbledhur nga:

- Pasqyrat financiare vjetore (bilanci i gjendjes, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, fluksi i parasë).
- Raportet mujore dhe tremujore operative.
- Evidencat e prodhimit dhe shpërndarjes së shërbimeve.
- Regjistrat e burimeve njerëzore.
- Raportet e kontrollit të brendshëm dhe auditimit.
- Procesverbalet dhe vendimet e Bordit të Drejtorëve.

Procesi i raportimit ka përfshirë:

- Mbledhjen dhe konsolidimin e të dhënave nga njësitë operative dhe administrative.
- Verifikimin e saktësisë së të dhënave financiare nga departamenti i financave.
- Analizën krahasimore me planin vjetor të biznesit dhe objektivat strategjike.
- Shqyrtimin dhe miratimin paraprak nga menaxhmenti ekzekutiv.
- Prezantimin dhe miratimin nga Bordi i Drejtorëve.

Hartimi i raportit është mbështetur në këto parime:

- Transparencë dhe llogaridhënie publike
- Saktësi dhe integritet i të dhënave
- Objektivet dhe raportim i balancuar
- Përputhshmëri me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kontabilitetit

Raporti mbulon periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2025 dhe përfshin analizë krahasimore me vitin paraprak, aty ku është e aplikueshme.

#### 4. Profili i Ndërmarrjes Publike

- Mandati dhe fusha e veprimtarisë

NPL Ku'zina ka ushtruar veprimtarinë e saj në përputhje me mandatin themelor dhe objektivat strategjike të përcaktuara me aktet themeluese dhe legjislacionin në fuqi.

Veprimtaria e ndërmarrjes është orientuar drejt ofrimit të shërbimeve cilësore në fushën e përgatitjes dhe furnizimit me ushqim, duke garantuar standarde të larta të sigurisë dhe efikasitetit operacional. Mandati i NPL Ku'zina konsiston me ofrimin e shërbimeve profesionale të përgatitjes, përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimit për institucione publike dhe komunitetin; sigurimin e cilësisë dhe sigurisë ushqimore në përputhje me standardet HACCP dhe rregulloret përkatëse ligjore; menaxhimin efikas, transparent dhe të përgjegjshëm të burimeve financiare dhe materiale; kontributin në programe sociale dhe mbështetjen e kategorive të ndryshme përmes ofrimit të shërbimeve ushqimore; Zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik duke ruajtur balancën ndërmjet misionit social dhe performancës financiare.

Gjatë vitit raportues, fusha e veprimtarisë është fokusuar në përgatitjen dhe distribuimin e ushqimit për shkolla, kopshte dhe institucione të tjera publike; menaxhimin e proceseve të punës në të gjitha pikat ku shërbën ndërmarrja; ofrimin e shërbimeve të kateringut për





aktivitete institucionale, publike dhe evente të ndryshme; furnizimin me ushqim të përgatitur sipas kërkesave dhe standardeve të përcaktuara.

Një fokus i veçantë ka qenë tek **zbatimi** i sistemit të kontrollit të brendshëm për sigurinë ushqimore; monitorimin e kushteve higjieno-sanitare në përputhje me legjislacionin në fuqi; trajnimin e stafit në fushën e sigurisë dhe menaxhimit të ushqimit.

Përvec kësaj ndërmarrja ka qenë e angazhuar edhe në rritjen e bashkëpunimin institucione, duke treguar gatishmëri për tu koordinuar me institucionet komunale në situata të ndryshme. dhe qendrore.

- Misioni dhe vizioni

### **Misioni**

Misioni i N.P.L. Ku'zina Sh.A. është ofrimi i ushqimit të shëndetshëm, të balancuar dhe me kosto të përballueshme për nxënësit dhe qytetarët përmes shërbimeve efikase, të përgjegjshme dhe inovative, duke u bazuar në praktika të mira higjienike, bashkëpunim me palët e interesit dhe përmirësim të vazhdueshëm.

### **Vizioni**

Vizioni është që të bëhet sinonim i ushqimit të shëndetshëm në Komunën e Prishtinës, të njihet si shembull i produkteve ushqimore për fëmijët, bizneset dhe qytetarët duke aplikuar praktika të mira evropiane.

### **Vlerat kyçe**

*Cilësia:* Të ofrojmë ushqime të standardit të lartë duke përdorur përbërës të freskët dhe cilësore.

*Qëndrueshmëria:* Të përdorim burime lokale, produkte organike dhe opsione të paketimit ekologjik.

*Inovacioni:* Të zbatojmë teknologji moderne në përgatitjen dhe shpërndarjen e ushqimit për të përmirësuar cilësinë e shërbimit.

*Efikasiteti:* Të optimizojmë operacionet për një shpërndarje dhe menaxhim me kosto efektive.

*Përputhshmëria:* Të ndjekim të gjitha rregullat dhe standardet e sigurisë ushqimore.

- Struktura organizative

Ku'zina Sh.A. ka zhvilluar një strukturë të mirë organizuar, të ndarë në njësi funksionale të përcaktuara sipas fushës së përgjegjësisë dhe nevojave operative. Organizimi mbështetet në parimin e ndarjes së punëve sipas tipologjisë, kompleksitetit dhe ndërveprimit ndërmjet funksioneve të ndryshme.

Njësitë kryesore organizative janë:

- Kryeshefi Ekzekutiv (CEO)
- Zyrtaari Kryesor Financiar dhe i Thesarit
- Zyrtaari i Auditimit të Brendshëm
- Këshilltari i Përgjithshëm – Sekretari
- Departamenti Ligjor dhe i Administratës





- Departamenti i Financave
- Departamenti i Prodhimit dhe Furnizimit
- Departamenti për Shitje dhe Marketing
- Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta

*Përshkrimi i shkurtër i funksioneve të departamenteve:*

*Departamenti Ligjor dhe i Administratës:* Menaxhon çështjet juridike dhe administrative me rëndësi për funksionimin e ndërmarrjes.

*Departamenti i Financave:* Përgjegjës për menaxhimin financiar, kontabilitetin dhe raportimin financiar të ndërmarrjes.

*Departamenti i Prodhimit dhe Furnizimit:* Mbikëqyr dhe koordinon përgatitjen e ushqimit në Kuzhinën Qendrore, duke siguruar standarde të larta të cilësisë dhe respektimin e dozimeve ushqimore.

*Departamenti për Shitje dhe Marketing:* Planifikon dhe zbaton strategjitë e marketingut dhe menaxhon marrëdhëniet me klientët.

*Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta:* Siguron mbështetje logjistike, teknike dhe operacionale për funksionimin efikas të të gjitha njësive të ndërmarrjes.

- Organet drejtuese:
  - Bordi i Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve ushtron funksionin e qeverisjes dhe mbikëqyrjes strategjike të ndërmarrjes, në përputhje me Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe aktet përkatëse nënligjore. Gjatë vitit raportues, Bordi ka miratuar planin e biznesit dhe buxhetin vjetor, ka monitoruar performancën financiare dhe operative të ndërmarrjes, si dhe ka mbikëqyrur zbatimin e objektivave strategjike. Përmes mbikëqyrjes së menaxhmentit dhe sigurimit të transparencës dhe llogaridhënies, Bordi ka kontribuar në forcimin e stabilitetit institucional dhe zhvillimit të qëndrueshëm të ndërmarrjes.

Gjatë vitit raportues, Bordi i Drejtorëve ka zhvilluar gjithsej 9 (nëntë) mbledhje të rregullta, në të cilat janë shqyrtuar dhe miratuar çështje me rëndësi strategjike dhe financiare për ndërmarrjen. Në këto mbledhje janë trajtuar raportet periodike të performancës, pasqyrat financiare, zbatimi i planit të biznesit dhe çështje të tjera që lidhen me funksionimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të ndërmarrjes. Përmes këtyre aktiviteteve, Bordi ka ushtruar në mënyrë aktive rolin e tij mbikëqyrës dhe ka siguruar llogaridhënie dhe transparencë institucionale.

Gjatë vitit 2025 janë audituar pasqyrat financiare për vitin 2024, kurse në muajin mars të vitit 2026 do iniciojmë procedurën për auditim të jashtëm të pasqyrave financiare për vitin 2025. Raporti i auditorit ka gjetur se Pasqyrat Financiare paraqesin në mënyrë të drejt dhe të saktë në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të NPL Ku'zina sh.a. në fund të vitit financiar dhe performancën e saj të vitit të përfunduar në atë datë, në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiarë për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme.

- Menaxhmenti Ekzekutiv





Menaxhmenti Ekzekutiv ka qenë përgjegjës për menaxhimin e përditshëm dhe zbatimin e vendimeve të Bordit të Drejtorëve, në përputhje me planin e biznesit dhe objektivat e miratuara për vitin raportues. Gjatë kësaj periudhe, menaxhmenti ka siguruar funksionim efikas operacional, menaxhim të qëndrueshëm financiar, respektim të obligimeve ligjore dhe përmirësim të proceseve të brendshme. Përmes koordinimit të strukturave organizative dhe mbikëqyrjes së performancës, Menaxhmenti Ekzekutiv ka kontribuar në arritjen e objektivave strategjike dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të ndërmarrjes.

## **6. Objektivat Strategjike dhe Operative për Vitin 2025**

Në funksion të vizionit dhe misionit të N.P.L. Ku'zina Sh.A., janë përcaktuar 7 objektiva strategjikë, të cilët përfaqësojnë drejtimet kryesore të zhvillimit të ndërmarrjes në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Këta objektiva janë formuluar mbi bazën e një analize gjithëpërfshirëse të kapaciteteve të brendshme, nevojave të tregut, kërkesave të klientëve dhe standardeve profesionale në sektorin e ushqimit institucional.

Çdo objektiv strategjik është i ndërlidhur me një fushë prioritare strategjike dhe i shoqëruar me objektiva specifike, të matshme dhe të afatizuara, të cilat e orientojnë organizatën drejt rezultateve konkrete dhe ndikimit të qëndrueshëm.

Këta 7 objektiva strategjikë janë të përfshirë dhe të harmonizuar me Planin e Veprimit, i cili përbën dokumentin operativ që ndan në mënyrë të detajuar hapat për realizimin e strategjisë. Plani i veprimit përfshin gjithashtu afatet kohore dhe indikatorët kyç të performancës (KPI), të cilët do të mundësojnë monitorimin dhe vlerësimin sistematik të përparimit drejt secilit objektiv.

## **7. Performanca Operative**

Të hyrat gjatë vitit 2025 kanë arritur vlerën prej 2,412,366.11 euro. Krahasuar me planifikimet, janë realizuar rreth 647,000 euro më pak të hyra. Kjo ka ardhur si rezultat i pritshmërive më të larta nga të hyrat e shërbimit tek shkollat si dhe te ushqimit/kateringut në sektorin privat.

Ndërmarrja ka blerë asete që janë përdorur për kompletimin e shkollave fillore si dhe për blerjen e pajisjeve të reja prodhuese. Vlera e këtyre pajisjeve për vitin 2025 është 410 mijë euro, ndërkohë që gjatë periudhës raportuese janë faturuar vetëm 178,559.32 euro. Të gjitha këto investime janë realizuara nga të hyrat vetanake të ndërmarrjes. Duke qenë se këtë vit jemi ballafaquar më një krizë të importuar financiare nga ana e Komunës së Prishtinës, ku si rezultat i saj, ndërmarrja nuk ka pasur mundësi të mbyll pagesat e të gjitha kontratave që ka pasur me operator ekonomike, viti 2025 është mbyllur më bilanc prej 316 mijë euro. Kjo do të thotë që viti është mbyllur me borxhe ndaj operatorëve ekonomik.

## **8. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore**

Ndërmarrja ka mbyllur vitin 2025 më një numër total të të punësuarve prej 128 të tillë. Sipas strukturës, departamenti i prodhimit zë numrin më të madh të të punësuarve, ku në tërësi janë 80 të punësuar. Duke qenë se viti 2025 është kategorizuar me probleme financiare për Komunën e Prishtinës, e që është reflektuar edhe tek ne, dhe si rezultat i saj në pjesën e fundit të gjysmës së parë të vitit kemi qenë të shtyrë që 28 të punësuar t'ua





ndërpresim kontratat e punës. Gjatë vitit 2025 u organizuan disa trajnime me synim rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit, ku ka pasur trajnime grupore dhe individuale.

Trajnimeve u janë nënshtruar të gjithë punonjësit e ndërmarrjes për temën: Marrëdhënie me publikun, menaxhimi i procesit të punës, kontratave dhe burimeve njerëzore në dy module, ndërsa për stafin e kuzhinës: në pesë module të tjera me temën: Siguria në punë. Gjatë këtij viti janë realizuar edhe trajnime që kanë qenë kërkesë e punonjësve:

Për ndihmës kuzhinier, 3 punonjës;

Siguria në punë, 2 punonjës

Fokusi kryesor ishte përmirësimi i aftësive teknike, sigurisë në punë dhe zhvillimit personal.

Ndërmarrja vazhdoi të promovojë një mjedis pune të sigurt dhe bashkëpunues përmes: respektimit të standardeve të shëndetit dhe sigurisë në punë, komunikimit të hapur ndërmjet menaxhmentit dhe stafit. Pagesat dhe përfitimet u zbatuan në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullores së brendshme: Paga bazë konkurruese në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe pagesa shtesë (paga e 13).

Struktura e të punësuarve në ndërmarrje është e diversifikuar. Mosha mesatare e të gjithë të punësuarve është 45 vjeç

Tabela: mesatarja e moshës dhe shkollimi i të punësuarve

| Përgatitja shkollore   |  |     |
|------------------------|--|-----|
| Fillor                 |  | 9   |
| I mesëm                |  | 72  |
| Bachelor               |  | 21  |
| Master                 |  | 9   |
| Totali i te punësuarve |  | 111 |

| Mosha mesatare         |  |     |
|------------------------|--|-----|
| 20-30                  |  | 11  |
| 31-40                  |  | 22  |
| 41-50                  |  | 39  |
| 51-60                  |  | 30  |
| 61-65                  |  | 9   |
| Totali i te punësuarve |  | 111 |

## 9. Menaxhimi Financiar

- Buxheti i miratuar për vitin 2025

Sipas Planit të Biznesit për vitin 2025, ndërmarrja ka synuar rritjen e të hyrave deri në vlerën 3.06 milionë euro. Gjatë kësaj periudhe, bazuar në Planin e Biznesit, është paraparë



realizimi i disa investimeve përmes hapave konkretë të punës, siç janë: zgjerimi i kapaciteteve prodhuese përmes investimit në pajisje teknologjike të reja. Po ashtu, është planifikuar modernizimi i transportit duke përmirësuar flotën e automjeteve përmes investimeve kapitale.

Aktivitete të tjera kanë qenë të lidhura me promovimin dhe prezantimin më të gjerë të punës së ndërmarrjes në media të shkruara dhe vizuale. Një aktivitet tjetër me rëndësi jetike i planifikuar ka qenë trajnimi i stafit në fushën e sigurisë ushqimore dhe shërbimit. Blerja e pajisjeve të reja ishte paraparë të realizohej përmes bashkëfinancimit nga Komuna e Prishtinës në vlerë prej 70,000 euro. Të gjitha këto aktivitete janë realizuar, mirëpo me vetëfinancim nga ndërmarrja.

- Të hyrat dhe shpenzimet

Ndërmarrja ka blerë asete që janë përdorur për kompletimin e shkollave fillore si dhe për blerjen e pajisjeve të reja prodhuese. Vlera e këtyre pajisjeve për vitin 2025 është 178,559.32 euro, investime këto të realizuara nga të hyrat vetanake të ndërmarrjes.

Aktiviteti tjetër që lidhet me modernizimin dhe veshjen e veturave frigo ndërmarrjes i ka kushtuar 40,889.84 euro, proces ky që do të vazhdojë edhe në vitin 2026.

Promovimi dhe brendimi i ndërmarrjes, i lidhur drejtpërdrejt me aktivitetet e marketingut të parashikuara në Planin e Biznesit, ka arritur vlerën 20,350.00 euro. Kjo kontratë për marketing dhe prezantim vizual në media do të vazhdojë edhe në vitin pasues.

Një tjetër qëllim thelbësor ka qenë zhvillimi dhe avancimi i stafit përmes trajnimeve profesionale. Vlera e këtyre shpenzimeve gjatë vitit 2025 është 24,549.00 euro. Vlen të theksohet se gjatë këtij viti ndërmarrja, për herë të parë, ka hartuar strategjinë e saj zhvillimore, dokument ky që përbën bazën e zhvillimit të ardhshëm dhe fundamentin e të gjitha dokumenteve strategjike të ndërmarrjes. Vlera e këtij dokumenti është 148,680.00 euro.

Shpenzimet të cilat marrin pjesë të konsiderueshme në të hyra janë dhe buxheti i pagave. Këtë vit kjo vlerë ka arritur në 867,875 euro. Gjatë këtij viti kemi pasur dhe punësime shtese sidomos në muajin Shtator. Për të arritur shërbimin e shujtave tek institucionet shkollore ka qenë e domosdoshme punësimi në pozita operative, shërbyese dhe shpërndarëse.

- Rezultati financiar

Të hyrat gjatë 2025 janë 2,412,366.11 euro neto. Pjesëmarrja e shpenzimeve totale (1,049,190.81 euro) në të hyra është 43%. Kurse vetëm shpenzimet për lëndë të parë marrin pjesë me 25% në të hyra. Gjithashtu pjesëmarrje prej 35% ka buxheti i pagave në totalin e të hyrave. Për blerjen e aseteve nga të hyrat kemi ndarë 7.40% gjatë vitit 2025. Duke qenë se këtë vit jemi ballafaquar më një krizë të importuar financiare nga ana e Komunës së Prishtinës, ndërmarrja ka mbyllur vitin më obligime ndaj OE në vlerë prej 316 mijë euro.






- Tabela financiare

|          |                                                              | Shuma në euro              |
|----------|--------------------------------------------------------------|----------------------------|
| <b>1</b> | <b>Të hyrat totale</b>                                       | <b><u>2,412,366.11</u></b> |
| <b>2</b> | <b>Shpenzimet Totale</b>                                     | <b><u>1,049,190.81</u></b> |
| 2.1      | Shpenzimet e lendes se pare                                  | 602,705.98                 |
| 2.2      | Shpenzime për naftë                                          | 9,589.27                   |
| 2.3      | Shpenzime për telefon                                        | 956.66                     |
| 2.4      | Shpenzime për trajnime-avancim                               | 24,549.00                  |
| 2.5      | Shpenzime të reprezentacionit                                | 1,320.74                   |
| 2.6      | Shpenzime tjera ( ushqimit)                                  | 1,354.75                   |
| 2.7      | Shpenzime të interneti                                       | 610.20                     |
| 2.8      | Shpenzime të rrymës                                          | 26,518.77                  |
| 2.9      | Shpenzime për material shpenzues                             | 654.75                     |
| 2.1      | Shpenzimet për zyre                                          | 1,469.95                   |
| 2.11     | Shpenzimet e reklamës dhe revistave                          | 240.00                     |
| 2.12     | Shpenzimet e higjienës                                       | 4,010.63                   |
| 2.13     | Shpenzimet e mirëmbajtjes se veturave, sigurimi dhe servisim | 7,379.27                   |
| 2.14     | Shpenzimet e paketimeve                                      | 8,387.02                   |
| 2.15     | Shpenzimet e GPS-ve                                          | 406.76                     |
| 2.16     | Shpenzimet e veturave rent                                   | 78,655.92                  |
| 2.17     | Shpenzimet e transportit                                     | 19,590.75                  |
| 2.18     | Shpenzimet e transportit jashtë vendit                       | 6,473.80                   |
| 2.19     | Shpenzimet e analizave IKSHPK                                | 3,824.75                   |
| 2.20     | Shpenzimet e sigurimit shëndetësor                           | 22,421.50                  |
| 2.21     | Shpenzimet e hartimit te strategjisë                         | 146,680.00                 |
| 2.22     | Shpenzimet e mirëmbajtjes se objektit DDD                    | 83.90                      |
| 2.23     | Shpenzimet e Auditimit                                       | 980.00                     |
| 2.24     | Shpenzimet e mirëmbajtjes                                    | 2,725.43                   |
| 2.25     | Shpenzimet e mirëmbajtjes se programit te kontabilitetit     | 72.88                      |
| 2.26     | Shpenzimet për shndërrimin e veturave ne Frigo               | 40,889.84                  |
| 2.27     | Shpenzimet e brendimit                                       | 20,350.00                  |
| 2.28     | 'Shpenzime për materiale / mjete pune                        | 256.42                     |
| 2.29     | Shpenzimet e qirasë se Objektit                              | 30,406.78                  |
| 2.30     | Shpenzimet për udhëtim-akomodim stafit për fund vit          | 8,000.00                   |
|          | Blerja e Aseteve                                             | 178,559.32                 |
| <b>3</b> | <b>Shpenzimet e pagave</b>                                   | <b>867,875.52</b>          |
|          | <b>Fitim/ Humbje</b>                                         | <b>316,740.46</b>          |

- Grafika dhe statistika

Kategoritë që kanë marr pjesë më së shumti në totalin e shpenzimeve dhe investimeve janë:

Shpenzimet e pagave me 41.41%, blerja e lëndës së parë me 28,76%, blerja e aseteve të reja-investim me 8.52%, hartimi i strategjisë zhvillimore me 5.93% dhe shpenzimet e veturave me qira me 3.75%. Të gjitha këto përbejnë 88% e shpenzimeve totale.



Për të analizuar sesi ka qenë veprimtaria biznesore e Npl Ku'zina do të analizojmë ndarjen e shpenzimeve dhe investimeve. Blerjet investive që ka pasur ndërmarrja gjatë vitit 2025 janë, blerja e aseteve për prodhim, shndërrimi i veturave frigo, hartimi i strategjisë, krijimi i brendimit si investim strategjik. Kurse shpenzimet tjera operative përfshijnë shpenzimet për paga, lënë e parë, naftë, telefon internet, transport, mirëmbajtje etj.

Sipas tabelës së të hyrave dhe shpenzimeve shohim që Investimet afatgjata si:

| Kategoria                      | Shuma (€)               |
|--------------------------------|-------------------------|
| Blerja e aseteve               | 178,559.32 <sup>1</sup> |
| Hartimi i strategjisë          | 146,680.00              |
| Shndërrimi i veturave në Frigo | 40,889.84               |
| Shpenzimet e brendimit         | 20,350.00               |
| <b>Totali=</b>                 | <b>364,104.25 €</b>     |

Kurse shpenzimet tjera operative përbejnë një total prej: 1,553,840.38€

**Pjesëmarrja në totalin e shpenzimeve:**

| Kategoria            | Totali         | Përqindja |
|----------------------|----------------|-----------|
| Shpenzimet operative | 1,553,840.38 € | 81%       |
| Investimet           | 364,104.25 €   | 19%       |

<sup>1</sup> Blera e aseteve në total gjatë periudhes raportuese është 410 mijë euro, por deri më 31.12.2025 është faturuar shumë e prezantuar me lartë.



Nga këtu shohim që struktura e shpenzimeve është tipike e një biznesi operativ me 81% të shpenzimeve të përqendruara në kosto ditore. Gjithashtu shohim që shpenzimet për lëndë të parë dhe paga përbejnë mbi 70% të shpenzimeve operative që tregon një varësi të madhe të veprimtarisë biznesore në punëtorë dhe prodhim si shërbim bazë.

- Subvencionet dhe mbështetja publike

Gjatë vitit 2025 ndërmarrja nuk ka pranuar subvencione as nga niveli lokal as nga niveli qendror.

## 10. Prokurimi dhe Investimet

Gjatë vitit 2025, aktivitetet e prokurimit janë zhvilluar në përputhje me planin vjetor të prokurimit dhe legjislacionin në fuqi. Qëllimi kryesor ka qenë siguri i furnizimeve dhe realizimi i investimeve të nevojshme për rritjen e kapaciteteve operationale dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar gjithsej:

16 procedura të prokurimit

Procedurat janë realizuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe afatet e parapara, duke garantuar transparencë, konkurrencë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Vlera e përgjithshme e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2025 është: 1,241,981.12 euro

Gjatë vitit 2025 janë realizuar këto investime kapitale:

Furnizimi me pajisje për prodhim dhe ruajtje të ushqimit - Investim i realizuar me qëllim rritjen e kapaciteteve prodhuese, përmirësimin e standardeve të sigurisë ushqimore dhe garantimin e kushteve optimale të ruajtjes.

Furnizimi me mobilie për kuzhinën qendrore - Investim që ka kontribuar në organizimin më efikas të hapësirave të punës në objektin e ri dhe përmirësimin e kushteve të operimit.

Shndërrimi i veturave Pick-Up nga gjendja standarde në sistem me frigo - Investim me rëndësi strategjike për sigurimin e transportit të kontrolluar të ushqimit, duke ruajtur standardet higjieno-sanitare gjatë shpërndarjes. Këto investime kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së shërbimit dhe në përmbushjen e standardeve teknike dhe ligjore në fushën e furnizimit me ushqim.

Më poshtë paraqitet tabela me detajet e plota të procedurave dhe vlerave përkatëse.

| Procedurat e Prokurimit gjate Vitit 2025 N.P.L "Ku'zina" sh.a |                   |                                                                                   |                                              |                |                    |
|---------------------------------------------------------------|-------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------|----------------|--------------------|
| Nr                                                            | Nr.Procedures     | Procedurat                                                                        | Tipi                                         | Vlera          | Data e nenshkrimit |
| 1                                                             | KQ-24-12724-2-1-1 | Hartimi i Strategjise Zhvillimore dhe Planifikimi Strategjik për NPL Kuzhina sh.a | Kontrate Publike                             | € 146,680.00   | 10.01.2025         |
| 2                                                             | KQ-25-1952-2-4-7  | Transporti i zyrtareve te kuzhines per vizite studimore                           | Kontrate Publike                             | 980,00         | 18.03.2025         |
| 3                                                             | KQ-25-2941-5-5-8  | Furnizimi me peme dhe perime                                                      | Kontrate Ndhimese,<br>Marreveshje<br>Kornize | € 113,775.00   | 24.04.2025         |
| 4                                                             | KQ-25-6396-2-2-1  | Servisimi dhe mirembajtja e veturave te Kuzhines                                  | Kontrate Kornize                             | € 15,186.40    | 14.08.2025         |
| 5                                                             | KQ-25-6441-1-1-1  | Furnizimi me artikuj ushqimor - produkte te peshkut                               | Kontrate Kornize                             | € 288,280.00   | 25.08.2025         |
| 6                                                             | KQ-25-6714-2-2-1  | Shendrimi i veturave Pick-UP nga situata standarde ne sistem me frigo             | Kontrate Kornize                             | € 86,850.00    | 04.09.2025         |
| 7                                                             | KQ-25-7642-1-2-1  | Furnizim me paketime ushqimore                                                    | Kontrate Kornize                             | € 13,837.00    | 03.10.2025         |
| 8                                                             | KQ-25-7159-1-1-1  | Furnizimi me pajisje per prodhim dhe ruajtje te ushqimit                          | Kontrate Publike                             | € 405,160.00   | 06.10.2025         |
| 9                                                             | KQ-25-3568-2-2-1  | Krijimi i identitetit (brendimi) dhe prezantimi medial per NPL Kuzhina            | Kontrate Kornize                             | 3,411.54       | 16.10.2025         |
| 10                                                            | KQ-25-10222-2-4-7 | Transporti i zyrtareve te kuzhines per vizite studimore                           | Kontratë publike                             | 700,00         | 11.11.2025         |
| 11                                                            | KQ-25-9572-5-5-8  | Furnizimi me peme dhe perime                                                      | Kontrate Ndhimese,<br>Marreveshje<br>Kornize | € 134,255.00   | 13.11.2025         |
| 12                                                            | KQ-25-8902-1-2-1  | Furnizimi me material higjenik                                                    | Kontratë kornizë                             | € 11,958.72    | 19.11.2025         |
| 13                                                            | KQ-25-11193-2-4-7 | Pastrimi gjeneral i objektit te kuzhines ne Lakrishte                             | Kontrate Kornize                             | 979,80         | 15.12.2025         |
| 14                                                            | KQ-25-10919-5-5-8 | Furnizimi me mobile per kuzhinen qendrore                                         | Kontrate Ndhimese                            | € 25,999.00    | 24.12.2025         |
| 15                                                            | KQ-25-11471-2-4-7 | DDD i objektit te ri te kuzhines ne Lakrishte                                     | Kontrate Publike                             | 988,00         | 24.12.2025         |
| 16                                                            | KQ-25-11509-2-4-7 | Sigurimi i automjeteve te kuzhines                                                | Kontratë publike                             | 705,29         | 26.12.2025         |
| Totali                                                        |                   |                                                                                   |                                              | € 1,241,981.12 |                    |

\* Krijimi i identitetit brendimit dhe prezantimi medial për NPL Kuzhina, vlere e paraqitur në tabelë është çmimi i poentuar 3,411.54 euro ndërsa çmimi total i shërbimeve është vlere e parashikuar ne deklaratën e disponushmerise se fondeve ne vlere prej: 124,000.00 euro.

## 11. Transparenca dhe Llogaridhënia

Gjatë vitit raportues 2025, NPL "Ku'zina" sh.a. ka zbatuar në mënyrë konsekuente parimet e transparencës, integritetit dhe llogaridhënies publike, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe standardet e qeverisjes korporative për ndërmarrjet publike.



Veprimtaria e ndërmarrjes është karakterizuar nga një qasje sistematike dhe e strukturuar ndaj raportimit, mbikëqyrjes dhe kontrollit institucional.

Mekanizmat e transparencës janë operacionalizuar përmes raportimit të rregullt financiar dhe operativ, prezantimit të pasqyrave financiare sipas standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar, si dhe përmes proceseve të auditimit. Pasqyrat financiare janë vlerësuar si të sakta dhe në përputhje me kërkesat profesionale, duke garantuar besueshmëri dhe integritet të informacionit financiar.

Bordi i Drejtorëve ka ushtruar në mënyrë aktive funksionin e mbikëqyrjes strategjike dhe të kontrollit, përmes shqyrtimit të vazhdueshëm të performancës dhe vendimmarrjes së bazuar në evidencë, duke siguruar përgjegjësi të plotë institucionale. Paralelisht, menaxhmenti ekzekutiv ka garantuar zbatim të disiplinuar të politikave dhe vendimeve, duke forcuar mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të rrezikut.

Në fushën e prokurimit publik dhe menaxhimit të burimeve, ndërmarrja ka zbatuar procedura transparente, konkurruese dhe të verifikueshme, duke respektuar parimet e trajtimit të barabartë dhe përdorimit efikas të fondeve publike. Këto praktika kanë kontribuar në rritjen e llogaridhënies financiare dhe operationale.

Përmes këtyre instrumenteve dhe praktikave, NPL "Ku'zina" sh.a. ka konsoliduar një kulturë institucionale të bazuar në transparencë, përgjegjësi dhe besueshmëri, duke forcuar legjitimitetin publik dhe duke krijuar bazë të qëndrueshme për zhvillim të mëtejshëm.

**Fund!**